



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Ilir META

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
PËR VITIN 2015**

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Bashkëveprimi me aktorët e tregut dhe institucionet, kryesisht entet rregullatore, për të siguruar një ekonomi funksionale tregu;
- Ndërgjegjësimi dhe rritjes së besimit të publikut në rolin e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës, e shprehur nëpërmjet rritjes së numrit të çështjeve të ankimuar pranë Autoritetit të Konkurrencës;
- Rritjes së numrit të ndërhyrjeve në treg dhe zgjerimit të llojeve të tregjeve, të cilat kanë qenë objekt i monitorimit dhe hetimeve në zbatim të ligjit;
- Konsolidimit të profilit si institucion i pavarur dhe profesional dhe forcimit të kapaciteteve institucionale;
- Plotësimi të mëtejshëm të kuadrit ligjor sekondar, me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian në fushën e konkurrencës.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2016, të përmirësojë punën në drejtim të:

- Ndërhyrjeve të vazhdueshme, sidomos në ato tregje, nga të cilat numri i ankesave nga aktorët është më i lartë dhe me ankesa të përsëritura çdo vit, për pretendime të sjelljeve abuzive në treg.

- Forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimeve të inspektorëve, me qëllim rritjen e ekspertizës jo vetëm për investigimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e firmave në treg. Përmirësimin e instrumenteve hetimore, sidomos për inspektimet e befasishme, për të siguruar evidenca apo prova të mjaftueshme në rastet e karteleve.

- Koordinimit me entet shtetërore për të garantuar më tepër konkurrencë në prokurimet publike dhe ndjekjen e rekomandimeve të dhëna në rastet e marrëveshjeve në oferta.

- Ndjekjes më rigoroze të proceseve gjyqësore dhe ekzekutimit të gjobave për eficientë të ligjit të konkurrencës.

- Shtimit të vëmendjes në rastet e rritjes së çmimit për mallrat dhe shërbimet që ofrojnë koncesionarët në dëm të konsumatorëve shqiptarë.

- Informimit të vazhdueshëm të Kuvendit për aktet ligjore që kufizojnë konkurrencën dhe opinionin e Autoritetit për të drejtat ekskluzive.

- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të drejtës europiane në këtë fushë, pasi është shumë i rëndësishëm arsyetimi i tyre, bazuar në interesin publik dhe vlerësimi i konkurrencës si një e mirë publike.

- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për politikën antikartel nëpërmjet aktiviteteve me të tretët dhe fushatave informuese adresuar bizneseve, lidhur edhe me përfitimet që vijnë si rezultat i pjesëmarrjes në programin e lehtësimit nga gjobat.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

- Për vlerësimin e efekteve reale të ndryshimit të paketës së kontrollit në eficientë të përdorimit të aseteve të dhëna me të drejtë ekskluzive, në rastet e transferimit të kuotave nga njëri mbajtës i së drejtës tek tjetri.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Miratuar në datën 19.5.2016